

Bordi i ERE me vendimin nr. 104, datë 30.04.2018, filloi procedurën për rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”

Ndryshimet e propozuara për rishikimin e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s, janë si vijon:

Ishte :

Neni 8

Llogaritja e Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit Llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, do të bëhet sipas formulës së mëposhtëme:

$$\text{ÇFMFt} = \text{KDFPt} + \text{CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

Ose:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + 10\% \text{CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

Ku:

CFMFt - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

KDFPt - Kosto Direkte e Furnizimit me Pakicë sipas pikës 6 të nenit 6

Ku:

*KDFPt - është 10% *CBEt*

CBEt Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit

TRrTSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t.

Bëhet:

Neni 8

- 1. Llogaritja e Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit Llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, do të bëhet sipas formulës së mëposhtëme:*

$$\text{ÇFMF}_t = \text{KDFP}_t + \text{CBE}_t + \text{TRrTSH}_t$$

$$\text{Ose: } \text{ÇFMF}_t = \text{CBE}_t + 10\% \text{ CBE}_t + \text{TRrTSH}_t$$

$$\text{ÇFMF}_t = \text{CBE}_t + \text{Pr} * \text{CBE}_t + \text{TRrTSH}_t + \text{CA}$$

Ku:

ÇFMF_t - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

KDFP_t - Kosto Direkte e Furnizimit me Pakicë sipas pikës 6 të nenit 6

Ku:

*KDFP_t - është 10% *CBE_t*

CBE_t Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit (Tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me preparesi (BRE))

TRrTSH_t Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t

Pr – Kthim per riskun i percaktuar per vitin

CA- Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit percaktuar sipas nenit 6 te kesaj metodologjie.

Pas pikës 8.1, shtohet pika 2 me përmbajtje si më poshtë:

2. Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë të klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014.